

Nr. _____ prot

Tiranë, më _____ 2020

KËRKESE PËR OFERTË

I nderuar Ofertues,

Me anë të këtij dokumenti ju ftoheni të merrni pjesë në procedurën konkurruese që do të zhvillohet nga shoqëria “**Albanian Gas Services Company**” Sh.A (i referuar edhe si Klienti) dhe të paraqisni Ofertën tuaj.

Procedure konkurruese qiraje nr.: AGSco 004/2020

Objekti: **Marrje me qira për ambient pune e një magazine në qytetin e Korçës.**

Kjo Kërkesë për Ofertë (KpO) dhe dokumentet që i referohet dhe që janë pjesë përbërëse e saj, nuk krijojnë asnjë lloj detyrimi ose angazhimi për t’i dhënë Kontratën Ofertuesve, as t’i atribuojë atyre të të drejtën për çdo lloj shërbimi nga Klienti.

Nënkuptohet që Ofertuesit nuk i njihet asnjë kompensim ose rimbursim për çdo shpenzim të shkaktuar gjatë përgatitjes së Ofertës.

Klienti rezervon të drejtën për të modifikuar, anuluar, revokuar, pezulluar, ndërprerë thirrjen për oferta në çdo kohë, ndërsa Ofertuesi nuk ka asnjë lloj pritshmërie apo ndonjë të drejtë për kompensim ose zhdëmtim.

Dorëzimi i Ofertës përbën një angazhim formal nga ana e Ofertuesit për të kryer aktivitetet e mbuluara nga Kontrata në rast se Ofertuesi është i suksesshëm.

1 – PËRKUFIZIMET DHE TERMINOLOGJIA E OFERTËS

1.1 Përkufizime

- “**Pranim**”: shfaqje e synimit të Ofertuesit të Suksesshëm për të pranuar Kontratën e dërguar nga **Klienti**, nëse jepet;
- “**Ofertues i Suksesshëm**”: **Ofertues**, i cili si rezultat i Procedurës së Ofertimit, përzgjidhet nga **Klienti** si pala tjetër kontraktuese për ekzekutimin e veprimtarive të përcaktuara në KpO. Në Kontratë, Ofertuesi i Suksesshëm përcaktohet si Kontraktues.
- “**Dhënie e Kontratës**”: përzgjedhja nga **Klienti**, e Ofertës që konsiderohet të jetë më e mira në fund të Procedurës së Ofertimit;
- “**Klient**”: “**Albanian Gas Services Company**” SH.A
- “**Dokumentet e Ofertës**”: dokumentacioni i përcaktuar dhe i përshkruar në nenin 2 të kësaj KpO.

“Ofertues”:	person fizik/personi juridik, marrës i kësaj KpO-je, i cili formulon një Ofertë për ekzekutimin e aktiviteteve të përcaktuara në KpO dhe në rast se është Ofertues i Suksesshëm, marrës i Kontratës;
“Ofertë”:	dokumentacioni i dërguar nga Ofertuesi që, në lidhje me furnizimin e punimeve, mallrave ose shërbimeve të kërkuara, jep të dhëna të hollësishme të ofertës në pajtim me metodat dhe kushtet e përcaktuara në KpO.
“Procedurë Ofertimi”:	procedura që fillon me lëshimin e KpO-së dhe që përfundon me Dhënien e Kontratës;
“KpO”:	ky dokument;
“Menaxher Kontrate”:	individ i caktuar nga Klienti në ngarkim të veprimtarive operacionale dhe/ose administrative të lidhura me ekzekutimin e Kontratës.

1.2 Terminologjia e Ofertës

Gjatë përgatitjes së Ofertës, **Ofertuesi** duhet të vërejë terminologjinë e miratuar nga **Klienti** në Dokumentet e Ofertës, siç përcaktohet në nenin e mëposhtëm “Dokumentet e Ofertës të Dhëna nga Klienti”.

1.3 Numërtimi i neneve të KpO-së

Numërtimi i neneve të KpO-së është tërësisht indikativ dhe nuk mund të jetë progresiv.

2 – DOKUMENTET E OFERTËS TË DHËNA NGA KLIENTI

Dokumentet e Ofertës të dërguara nga **Klienti** për **Ofertuesin**, janë:

- 2.1 Kërkesa për ofertë (KpO)
- 2.2 Objekti i Punës (Aneksi 1)
- 2.3 Deklaratë për plotësimin e kriterëve administrative (Aneksi 2)
- 2.4 Oferta ekonomike (Aneksi 3)
- 2.5 Deklaratë për plotësimin e kërkesave teknike (Aneksi 4)
- 2.6 Draft Kontrata
- 2.7 Rregulloria e Sigurisë

3 – MBLEDHJE SHPJEGUESE

Klienti ka të drejtë të ftojë çdo ofertues në një mbledhje ("Mbledhje Shpjeguese") gjatë së cilës përmbajtja e Dokumenteve të Ofertës do të shqyrtohet dhe sqarohet. Mbledhja Shpjeguese do të zhvillohet në ditën dhe në orën e komunikuar për çdo Ofertues nga Klienti. Secili Ofertues rezervon të drejtën të vendosë nëse do të marrë pjesë ose jo në Mbledhjen Shpjeguese. Pas Mbledhjes Shpjeguese, secili Ofertues do t'i dërgohet një dokument që përmban të gjitha pyetjet, sqarimet dhe integrimet që rrjedhin nga këto mbledhje. Ky dokument do të përbëjë pjesë integrale të Dokumenteve të Ofertës

4 – KËRKESAT PËR SHPJEGIM DHE INFORMIM- VENDI I KOMUNIKIMEVE

- 4.1 Gjatë Procedurës së Ofertimit çdo komunikim duhet të jetë vetëm në formë me shkrim. Çdo kërkesë për shpjegim/informim mund të paraqitet nga **Ofertuesi** të para

afatit për paraqitjen e Ofertave dhe duhet të dërgohet ekskluzivisht në adresën dhe personit të përcaktuar më poshtë:

Në vëmendje të Z. Drini Mataj

email: drini.mataj@albgaz.al

- 4.2 Përgjigja e **Klientit** ndaj çdo kërkesë do t'i njoftohet të gjithë **Ofertuesve** të tjerë, pa identitetin e Ofertuesit që njoftoi kërkesën fillestare, kurdoherë që dhe në masën në të cilën përgjigja e lartpërmendur mund të jetë me interes të përbashkët për të gjithë **Ofertuesit**.
- 4.3 **Klienti** në çdo rast, ka të drejtë për të kërkuar të gjitha shpjegimet dhe çdo informacion që çmohet i nevojshëm.
- 4.4 Shpjegimet e dhëna do të konsiderohen pjesë integrale e Dokumenteve të Ofertës.
- 4.5 Nëse **Ofertuesi** nuk dëshiron të paraqesë një Ofertë, duhet të njoftojë menjëherë dhe formalisht **Klientin** për këtë heqje dorë me shkrim (e-mail).

5 – KONFIDENCIALITETI DHE ANTI-KORRUPSIONI

Ofertuesi merr përsipër të:

- a) shqyrtojë të gjithë informacionin e dhënë në Dokumentet e Ofertës, si edhe çdo informacion tjetër të marrë gjatë vëzhgimit në terren (kur kërkohet), rreptësisht konfidencial dhe për të marrë të gjitha masat arsyeshmërisht të mundshme për të garantuar dhe mbrojtur konfidencialitetin e këtij informacioni nga cilido, me përjashtim të departamenteve dhe mbikëqyrësve të **Klientit**.
- b) mos riprodhojë dhe/ose përdorë informacionin e dhënë nga **Klienti**, duke përgatitur ekstrakte përmbledhëse për qëllime të ndryshme nga ato që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e Ofertës dhe në çdo rast për çdo shkelje për të cilën do të jetë përgjegjës nga **Klienti** për çdo dëm rrjedhues.
- c) mos përdorë informacionin e dhënë nga **Klienti** për qëllime të favorshme dhe në rast të ndonjë shkeljeje, do të jetë përgjegjës nga **Klienti** për çdo dëm rrjedhues.
- d) ekzekutojë Marrëveshjen e Konfidencialitetit.

6 – AFATI I PARAQITJES DHE VLEFSHMËRIA E OFERTËS

6.1 Afati për paraqitjen e Ofertës

Afati i caktuar për paraqitjen e Ofertës, është data **17.09.2019, ora 16⁰⁰**

Brenda afatit të mësipërm, **Ofertuesi** duhet të paraqesë ofertat e “Seksionit Administrativ”, “Seksionit Teknik” dhe “Seksionit Ekonomik”. Pas afateve të lartpërmendura, do të shkaktojë automatikisht përjashtimin e Ofertuesit nga procedura.

6.2 Vlefshmëria e Ofertës

Ofertuesi zotohet ta ruajë Ofertën të fiksuar dhe të parezervuar për 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas afatit për paraqitjen e Ofertave.

7 – KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS

- 7.1 Kontrata do të jepet bazuar në kriterin e “Çmimit më të ulët”. Si rrjedhojë, kontrata do t'i jepet **Ofertuesit**, i cili do të ofrojë ambjentin e kërkuar brenda një periudhe kohore 1 muajore nga data e nënshkrimit të kontratës, dhe që plotëson kriteret administrative, teknike dhe ka paraqitur ofertën ekonomike me çmimin më të ulët.

Klienti rezervon të drejtën për të kërkuar Oferta më të mira.
Vetëm ato oferta që çmohen të pranueshme nga **Klienti** nga pikëpamja administrative dhe teknike, do t'i nënshtrohen vlerësimit të çmimit.

8- PËRMBAJTJA E OFERTËS

Ofertuesi që ka shqyrtuar dokumentet e përmendura në nenin 2- “Dokumentet e Ofertës të dhëna nga Klienti”, përgatit Ofertën e tij.

Oferta me datë duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor/ personi fizik (individ) **Ofertuesit dhe duhet të jetë detyrues për Ofertuesin**, duke përcaktuar qartë emrin, mbiemrin e tij dhe rolin e shoqërisë/emërimin dhe duhet të shoqërohet nga një kopje e një dokumenti të vlefshëm të kartës së identitetit. Nëse kërkohet nga **Klienti**, **Ofertuesi** duhet të provojë në nivel të mjaftueshëm fuqinë/autoritetin e nënshkruesit për të nënshkruar.

Oferta përbëhet nga seksionet/rubrikat e mëposhtme të ndara:

- administrative (Seksioni Administrativ i Ofertës);
- teknike (Seksioni Teknik i Ofertës);
- ekonomike (Seksioni Ekonomik i Ofertës).

Të gjitha dokumentet e Ofertës të përmendura në Seksionet Administrative, Teknike dhe Ekonomike, përbëjnë pjesë integrale dhe thelbësore të Ofertës.

Çdo dokument që është pjesë e Ofertës duhet të përpilohet në letër dhe duhet të përcaktojë emrin dhe mbiemrin, nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor / personi fizik (individ) si dhe vulën dhe nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor të **Ofertuesit** (ose personit tjetër të pajisur me kompetencat e nevojshme). Për qëllim të qartësisë, vetëm dokumentet që dorëzohen nga **Ofertuesi**, të cilat sipas ligjit janë marrë nga autoritetet/organet/individët e deleguar për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve ose dokumenteve /akteve të tjera të parashikuara në KpO, përjashtohen nga kjo kërkesë.

(AGSco dhe ofertuesit duhet të ndjekin rregullat e Kodit të Etikes sipas linkut:

<http://www.snam.it/it/etica-governance/etica-impresa/codice-etico/>):

9 – SEKSIONI ADMINISTRATIV I OFERTËS

Seksioni Administrativ i ofertës është gjithëpërfshirës me dokumentacionin e mëposhtëm:

9.1.1 Ofertuesi kur është subjekt tregtar duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv).
- b) nuk është dënuar për shkelje penale,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

9.1.2 Ndërsa kur është person fizik (individ) duhet të deklarojë se nuk ka barrë hipotekore dhe nuk është dënuar për shkelje penale.

Ofertuesi fitues duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin origjinal ose fotokopje të noterizuar të përcaktuar në pikën 9.1, përpara nënshkrimit të kontratës.

9.2 Dokumenti të vlefshëm të kartës së identitetit/pasaportës të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë/individit;(origjinal ose fotokopje të noterizuar)

9.3 Certifikatën e pronësisë së objektit ose cdo dokumentacion tjetër provues të

pronësisë së objektit (original ose fotokopje te noterizuar)

9.4 Kërkesat për burime njerëzore të Ofertës

Ofertuesi duhet të paraqesë:

- 9.4.1 deklaraten për pranimin e përmbytjes së “Kërkesave të sigurisë për dokumentin e kontraktuesit;
- 9.4.2 deklaratën se në përgatitjen e Ofertës ka marrë parasysh detyrimet e lidhura me rregulloret që rregullojnë sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit (ligjin, rregullat etj), kushtet e punës, sigurimet shoqërore dhe mirëqenien, në fuqi në Shqipëri.
- 9.4.3 deklaratën e angazhimit të Ofertuesit, nëse duhet të jetë e nevojshme për të vepruar në mjedise me ndotje të dyshuar ose në hapësira të kufizuara, për të respektuar masat e sigurisë të parashikuara nga ligji shqiptar dhe si rrjedhojë, për të përdorur vetëm punëtorët e kualifikuar për të kryer aktivitete në mjediset e lartpërmendura;
- 9.5 përcaktimin nëse vendi ku **Ofertuesi** dëshiron të marrë komunikime të lidhura me ekzekutimin e Kontratës, nëse Ofertuesi bëhet Ofertuesi i Suksesshëm;
- 9.6 Deklaratën e **Ofertuesit** që përcakton se ka analizuar sipas rregullave dhe është njohur me të gjitha Dokumentet e Ofertës të përmendura në nenin 2 të kësaj KpO-je, kërkesat e lidhura, specifikimet dhe standardet referuese, si edhe nenet përkatëse kontraktuale të pranishme në Draft Kontratë dhe për të rënë dakord dhe marrë përmbytjen e saj.

10 – SEKSIONI TEKNIK I OFERTËS

Dokumentacioni teknik i paraqitur nga Ofertuesi, është: i hollësishëm, i plotësuar me të gjithë elementët e tij (planimetrinë e godinës së banimit dhe zyre), në përputhje me Aneksin 1.

Ofertuesi duhet:

- 10.1 Të japë një deklaratë (sipas Aneksit 2) me të cilën merr përsipër të plotësojë të gjitha kërkesat e Aneksit 1 si dhe duhet të dorëzojnë planimetrinë përkatëse mbi organizimin e ambientit;
- 10.2 Të japë një deklaratë me të cilën merr përsipër të kërkojë dhe marrë nga nënkontraktuesit e vet, dokumentacionin e përmendur në pikat e mësipërme.

10.4 Nënkontrata

10.4.1 Për sa i përket nënkontraktimit, kushtet e hollësishme të parashikuara në dokumentet e Kontratës që nënkupton se **Ofertuesi** duhet të paraqesë një deklaratë që përcakton:

- a) një listë të hollësishme të punimeve/veprimtarive që **Ofertuesi** synon të nënkontraktojë;
- b) një listë të nënkontraktuesve potencialë, në referencë të pikës a) më lart, për çdo punë/veprimtari individuale që synon të nënkontraktojë. Për çdo nënkontraktues, duhet të përcaktojë Emrin e Shoqërisë, formën ligjore, Numrin e Regjistrimit të

TVSH-së dhe Kodin e Taksapaguesit.

- c) një dokument që provon se **nënkontraktuesit** i jepet një sistem i menaxhimit të cilësisë, i çertifikuar nga një Organ i Akredituar në përputhje me Standardin ISO 9001-2008;
- d) një deklaratë që përcakton se ka kryer, me reagim pozitiv, kontrollet mbi përshtatshmërinë teknike-profesionale të nënkontraktuesit;
- e) një deklaratë të angazhimit për të garantuar që nënkontraktuesi udhëzohet për rregulloret profesionale të shëndetit dhe sigurisë;

11 – METODA E PARAQITJES SË OFERTËS

11.1 Seksioni “Administrativ” i Ofertës

Propozimi Administrativ i Ofertës duhet të dorëzojë në një zarf të vulosur me shënimin e mëposhtëm dhe ta dorëzojë në protokollin e:

“Albanian Gas Services Company” SH.A
Adresa: Rruga “Kosovareve”, pallati: NderPro, kati i I, Tiranë
Në vëmendje të **Z. Drini Mataj**
Procedure konkurruese nr.: AGSco 004/2020
“Propozimi Administrativ”

11.2 Seksioni “Teknik” i Ofertës

Propozimi Teknik i Ofertës duhet të paraqitet me formulimin e mëposhtëm në adresën e mëposhtme:

“Albanian Gas Services Company” SH.A
Adresa: Rruga “Kosovareve”, pallati: NderPro, kati i I, Tiranë
Në vëmendje të **Z. Drini Mataj**
Procedure konkurruese nr.: AGSco 004/2020
“Propozimi Teknik”

11.3 Seksioni “Ekonomik” i Ofertës

Propozimi Ekonomik i Ofertës (sipas Ankesit 3)duhet të paraqitet në një zarf të vulosur me formulimin e mëposhtëm në adresën e mëposhtme:

“Albanian Gas Services Company” SH.A
Adresa: Rruga “Kosovareve”, pallati: NderPro, kati i I, Tiranë
Në vëmendje të Znj. **Z. Drini Mataj**
Procedure konkurruese nr.: AGSco 004/2020
“Propozimi Ekonomik”

- 11.4 Mosrespektimi i sugjerimeve të parashikuara në këtë nen përbën shkak të drejtë për përjashtimin e **Ofertuesit** nga Procedura konkurruese, ku kjo përcakton shkeljen e fshehtësisë së ofertës, barazinë e kushteve ndërmjet pjesëmarrësve dhe /ose mund të ndikojë në vlerësimin e vetë ofertave.

12 - GJUHA DHE MONEDHA E VLEFSHME PËR OFERTËN

- 12.1 Oferta dhe të gjitha deklaratat e përmendura në formularët bashkëlidhur KpO, duhet të formulohen **në gjuhën shqipe**.

- 12.2 Të gjitha çmimet dhe tarifat duhet të shprehen **në Lekë**.

13 - KONTROLLI DHE VLERËSIMI I OFERTAVE- ARSYET PËR PËRJASHTIM NGA THIRRJA PËR OFERTA

13.1 Kontrolli dhe vlerësimi i ofertave

Klienti kontrollon Ofertën siç përshkruhet më poshtë:

Në vlerësimin e Seksioneve Administrative dhe Teknike të Ofertës, **Klienti** rezervon të drejtën për ti kërkuar **Ofertuesit** integritet dhe/ose sqarimet që çmohen të nevojshme. Nëse edhe pas marrjes së integritetit dhe/ose sqarimeve të lartpërmendura, këto Seksione të Ofertës, me diskrecionin e vetëm të **Klientit**, ende çmohen të papërshtatshme, Seksioni Ekonomik i Ofertës nuk do të merret në konsideratë dhe Oferta Ekonomike do t'i kthehet **Ofertuesit**.

13.2 Arsyet për përjashtime nga thirrja për oferta

Ndodhja e ndonjë prej rasteve të mëposhtme përbën shkak për përjashtim:

13.2.1 Mosparaqitja në kohë e percaktuar Propozimit Administrativ, Teknik dhe Ekonomik;

13.2.2 Mos-përgatitja (plotësisht ose pjesërisht) e deklaratave/certifikatave të kërkuara ose paraqitja e deklaratave/certifikatave të çrregullta, të rreme ose të paplota, pa cenuar kushtet e parashikuara me ligj;

13.2.3 Mosrespektimi i dispozitave të përcaktuara sipas paragrafit 5 të këtij KpO.

Gjatë Procedurës së Ofertimit, **Ofertuesi** ka detyrimin për t'i komunikuar menjëherë me shkrim **Klientit** çdo ndryshim që mund të ketë ndodhur në kërkesat e tij subjektive dhe/ose në kapacitetin teknik-organizativ dhe/ose ekonomik-financiar.

Nëse **Ofertuesi** nuk mund të pajtohet me sa më lart ose nëse pas ndryshimeve të mëposhtme, **Ofertuesi** nuk është më në zotërim të kërkesave të nevojshme për ekzekutimin e veprimtarive të mbuluara nga kjo KpO, Klienti rezervon të drejtën për të përjashtuar **Ofertuesin** nga thirrja për oferta.

ADMINISTRATORI

ARBER LLESHI

ANEKSI 1

KËRKESAT TEKNIKE (scope of work)

Objekti: Marrje me qira e një magazine në qytetin e Korçës me karakteristikat e mëposhtme:

Ambienti që do të ofrohet duhet të jetë jo më pak se 300 m² dhe jo më shumë se 350 m², i organizuar:

- Të paktën 2 (dy) hyrje para dhe mbrapa e përshtatshme për transpaleta
- Të paktën 1 (një) tualete (lavaman, WC)
- Të ofrojë mundësi për hyrje dhe parkim trajleri
- Të ketë një ambient të veçantë që të përdoret për zyrë

Ambjentet të jenë të pajisura minimalisht me:

- rrjet elektrik sipas standardeve (të gjitha prizat duhet të kenë tokëzim)
- ndriçim të përshtatshëm

Subjekti qiradhënës fitues duhet të sigurojë pajisjen e ambientit me mjetet kundër zjarrit

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit

Prona që do të merret me qira preferohet të jetë pranë qendrës së qytetit si dhe me akses të mirë pranë daljeve të qytetit të Korçës dhe jo më largë se 1 (një) kilometër nga zyrat aktuale të AGS Co në Korçës.

ANEKSI 2

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE ADMINISTRATIVE

Deklaratë e ofertuesit pjesemarrës në procedurën konkurruese që do të zhvillohet në datë 11.11.2020 nga shoqëria “Albanian Gas Services Company” Sh.A me objekt: Marrje me qira e një magazine në qytetin e Korçës.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e administratorit të shoqërisë/ person fizik (individ) _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Ofertuesi _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. (nuk aplikohet për person fizik (individ))

Ofertuesi _____ nuk është dënuar për vepra penale.

Ofertuesi _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale., ndërsa për ofertuesin person fizik (individ) nuk është në proces hetimi penal.

Ofertuesi _____ nuk është në proces falimentimi (status aktiv) dhe kur është person fizik (individ) duhet të deklaroj se nuk ka barrë hipotekore

Në çdo rast, AGS sh.a ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

ANEKSI 3

Tiranë, më 06.08.2019

OFERTA EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit: _____

* * *

1	2	3	4	5	6
Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Sasia	Çmimi mujor	Çmimi Total	Afati
I.	Qira ambienti zyre, dhe parkimi	12			1 vit
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në monedhën **Lekë**

ANEKSI 4

DEKLARATË

Deklaratë e ofertuesit pjesëmarrës në procedurën konkuruese, që do të zhvillohet në datë 11.11.2020 nga shoqëria “Albanian Gas Services Company” SH.A me objekt: Marrje me qira e një magazine në qytetin e Korçës.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit ligjor _____ të personit juridik/person fizik (invid) deklaroj se do të përmbush të gjitha kërkesat teknike, të përcaktuara në dokumentat e Klientit.

Data e dorëzimit të deklaratës _____2020.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula